

Në bazë të nenit 52 paragrafi (3) të Ligjit për Arsimin Fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

K A L E N D A R
PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E SHKOLLAVE FILLORE
NË VITIN SHKOLLOR 2022/2023

Neni 1

Me këtë kalendar përcaktohet organizimi i vitit shkollor në shkollat fillore në përputhje me njësitë programore në vitin shkollor: gjysmëvjetori, format e tjera të veprimtarisë edukativo arsimore dhe pushimet të nxënësve për vitin shkollor 2022/2023.

Neni 2

Viti shkollor në shkollat fillore fillon më 1 shtator 2022 ndërsa përfundon më 31 gusht 2023.

Viti shkollor fillon më 1 shtator 2022 dhe përfundon më 9 qershor 2023.

Neni 3

Viti shkollor përbëhet nga dy gjysmëvjetore - gjysmëvjetori I dhe II.

Gjysmëvjetori i parë fillon më 1 shtator 2022 dhe përfundon më 30 dhjetor 2022.

Gjysmëvjetori i dytë fillon më 18 janar 2023 dhe përfundon më 9 qershor 2023.

Neni 4

Gjatë vitit shkollor nxënësit përdorin pushimet dimërore dhe verore.

Pushimi dimëror fillon më 31 dhjetor 2022 dhe përfundon më 17 janar 2023.

Gjatë pushimit dimëror, punonjësit e shkollave nga data 02.01.2023 deri më 10.01.2023 shfrytëzojnë ditë jopune me pagesë.

Pushimi verorë fillon më 10 qershor 2023 dhe përfundon më 31 gusht 2023

Neni 5

Nga data 12 qershor deri më 23 qershor 2023, shkollat fillore organizojnë mësim plotësues, provim përmisues dhe provim klasor , , ndërsa nga data 15 gusht deri më 21 gusht 2023, organizojnë orë përgatitore, konsultime dhe forma të tjera ndihmë të nxënësve që duhet të cilët duhet të nënshtrohen provimeve plotësuese. dhe provimet klasore dhe I zbatojnë ato.

Neni 6

Puna edukativo-arsimore për nxënësit organizohet gjatë gjithë javës së punës.

Neni 7

Në vitin shkollor 2022/2023 mësimi zhvillohet në 180 ditë mësimore.

Neni 8

Në ditën e shkollës organizohen manifestime kulturore, sportive dhe të tjera.

Dita tradicionale e arsimit për pjesëtarët e bashkësive që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga Gjuha Maqedone shënohet me organizimin e manifestimeve kulturore etj.

Dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimit për pjesëtarët e bashkësive që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga Gjuha Maqedone, janë ditë mësimore kur zhvillohen programe të veçanta për manifestimin nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni .

Neni 9

Ditët e punës kur kryhen ekskursionet e nxënësve dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimit për pjesëtarët e bashkësive që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë ditë mësimore kur zhvillohen programe të veçanta.

Për nxënësit që nuk ndjekin ekskursionet, shkolla organizon mësim të rregullt në përputhje me orarin mësimorë.

Neni 10

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij kalendari, pushon së vlefshmi kalendari për organizimin dhe punën e shkollave fillore në vitin shkollor 2021/2022 në shkollat fillore publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 159/21 13/22, dhe 127/22).

Neni 11

Ky kalendar hyn në fuqi në ditën e ardhëshme nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 shtatori 2022.

Бр. Nr 18-9448/2

09.08.2022 viti/ година

Скопје/ Шкуп

**Министер за образование и наука,
Ministër i Arsimit dhe Shkencës**

Doc. Dr. Jeton Shaqiri